



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 108 Akti

Nr. 203 Vendimi
Tiranë, më 6.11.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në Tiranë, në datën 4 nëntor 2019, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Sulejman Kurti**, gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Lulzim Hamitaj, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi në tërësi çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit, z. Sulejman Kurti, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 4.11.2019, kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Sulejman Kurti, për shkak të funksionit si gjyqtar/drejtues në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016¹.

2. Pas hedhjes së shortit, trupi gjykues nr. 1 – i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Lulzim Hamitaj dhe Firdes Shuli – pasi administroi dhe studioi tri raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 20.3.2018, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohet kryesuesi i trupit gjykues, komisionere Firdes Shuli. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

3. Më pas, për arsye objektive pamundësie, në bazë të vendimit nr. 40, datë 16.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, “Për rishpërndarjen me short dhe transferimin e dosjeve të çështjeve të komisionerit Alma Faskaj”, nëpërmjet procedurës së shortit, anëtarja e trupit gjykues, komisionere Alma Faskaj, u zëvendësua nga komisionere Valbona Sanxhaktari.

4. Në vijim të hapave hetimore, në datën 10.10.2019, me vendimin nr. 2, trupi gjykues vendosi të mbyllë fazën hetimore dhe, në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për z. Sulejman Kurti të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit dhe përkatësisht, në kontrollin e pasurisë, të figurës dhe në atë profesional.

5. Në datën 15.10.2019 Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda datës 25.10.2019; (iii) të njihet me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative.

6. Subjekti i rivlerësimit nuk u njoh me dosjen, por ka paraqitur shpjegimet dhe parashtrimet e tij në Komision, brenda afatit të caktuar.

7. Në datën 30 tetor Komisioni ka njoftuar subjektin, në rrugë elektronike, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, për datën e seancës dëgjimore, të caktuar për më 4.11.2019, datë në të cilën u zhvillua rregullisht, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent – pa përfaqësues – dhe paraqiti shpjegimet dhe argumentimet e veta.

II. SEANCA DËGJIMORE

8. Seanca dëgjimore e datës 4.11.2019 – për subjektin e rivlerësimit, z. Sulejman Kurti – u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016 edhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

¹ Paragrafi 3, i nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), parashikojnë se: “Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*”.

9. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit – dhe të kaluara si barrë prove, apo për shpjegime.

10. Z. Sulejman Kurti, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e vet, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

11. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës dëgjimore, iu përgjigj pyetjeve të bëra nga trupi gjykues dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar, si dhe shprehu qëndrimin e tij përfundimtar të argumentuar dhe në konkluzion kërkoi konfirmimin në detyrë.

12. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Sulejman Kurti, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

13. Seanca dëgjimore e datës 4.11.2019 u mbyll, për të rifilluar në datën 6.11.2019, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

14. Z. Sulejman Kurti ka mbajtur një qëndrim bashkëpunues me Komisionin, duke dhënë përgjigje sa herë është pyetur dhe ka paraqitur dokumentacion mbështetës për shpjegimet e veta edhe në lidhje me burimet financiare të personave të tjerë me të cilët kishte pasur marrëdhënie financiare.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

15. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- i. provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, ‘Vetting’”;
- ii. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- iii. raportet dhe informacionet mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- iv. provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- v. deklarinimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik me Komisionin;
- vi. shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, si dhe argumentimeve me gojë të bëra nga subjekti në seancën dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit;
- vii. deklarinimet e personave të lidhur, apo të tjerë të lidhur;
- viii. faktet e njohura botërisht.

A. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË

16. Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklarinimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Sulejman Kurti, ku konstatohet se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklaram të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

17. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016.

18. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarameve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për rivlerësim në zbatim të ligjit nr. 84/2016:

- i. truall me sipërfaqe 163 m², nga e cila 119.5 m² ndërtesë, me vlerë 3.785.960 lekë, e ndodhur në Librazhd;
- ii. apartament (garsoniere) me sipërfaqe 33.78 m², me vlerë 4.391.400 lekë, e ndodhur në “***”, Tiranë;
- iii. autoveturë tip “Daimler Chrysler”, prodhim i vitit 2005, blerë në vitin 2016, në vlerën 400.000 lekë;
- iv. gjendje *cash* në vlerën 100.000 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshorten.

Vlerësimi i pasurisë

❖ Truall me sipërfaqe 163 m², nga e cila 119.5 m² ndërtesë, e ndodhur në Librazhd

19. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 dhe më pas është deklaruar edhe një ndërtim shtesë i kryer në vitin 2005. Po ashtu, edhe në deklaratën “Vetting” subjekti e ka deklaruar këtë pasuri si të përfituar nga: kontrata e blerjes së truallit, në datën 14.4.1999; ndërtimi i katit të I-rë në vitet 1997 - 1998; dhe në vijim ndërtimi i katit të II-të në vitin 2005.

20. Në deklaratën “Vetting” kjo pasuri është deklaruar në vlerën 3.785.960 lekë, të përlogaritur në bazë të një aktvlerësimi të vitit 1998 për katin I-rë dhe të një preventivi për katin II-të, që është ndërtuar në vitin 2005.

21. Për ndërtimin e kësaj banese – në deklaramet periodike të pasurisë, por edhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit – subjekti ka deklaruar si burime disa hua dhe ndihma nga familjarët e tij, ndërkohë që në deklaratën “Vetting”, si burim financiar për realizimin e kësaj pasurie është deklaruar “*me të ardhurat familjare*”.

22. Nga analiza e përgjigjeve të institucioneve dhe të dokumentacionit të administruar nga Komisioni, ka rezultuar se ZVRPP-ja Librazhd ka konfirmuar pasurinë nr. ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, truall me sip. 163 m² (që përbëhet nga bashkimi i dy pjesëve: 138 m² dhe 25 m²), nga e cila 119.5 m² ndërtim.

23. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 subjekti deklaroi vlerën prej 1.800.000 lekësh të pasurisë truall me sip. 138 m², mbi të cilin 92 m² ishin ndërtesë, si dhe vlerën 50.000 lekë të një tjetër pasuri truall me sip. 25 m². Ndërsa në pyetësin nr. 2, datë 4.3.2019, subjekti ka deklaruar se ndërtimi me sip. 91 m² i katit përdhes ka pasur një kosto totale prej 410.000 lekësh.

24. Për këtë pasuri Komisioni ka administruar dokumentacionin në vijim:

- i. certifikatë për vërtetim pronësie, datë 7.3.2007, për pasurinë me nr. ***, e llojit truall me sip. 163 m² dhe ndërtesë me sip. 119.5 m², në pronësi të Sulejman Kurtit dhe harta treguese e regjistrimit;
- ii. vërtetim pronësie nr. *** prot., datë 13.9.1999, lëshuar nga ZVRPP-ja Librazhd, e cila konfirmon regjistrimin në emër të Sulejman Kurtit të pasurisë me nr. ***, truall me sip. 138 m², nga e cila 94.5 m² ndërtesë;
- iii. kontratë shitblerje nr. ***, datë 14.4.1999, trualli me sip. 138m², me çmim shitjeje 66.240 lekë, palë shitëse Bashkia Librazhd;
- iv. aktvlerësimi të përgatitur nga Zyra e Urbanistikës së Bashkisë Librazhd, sipas së cilës objekti vlerësohet 91 m² x 20.000 lekë/m² = 1.820.000 lekë;
- v. leje ndërtimi datë 27.5.1998 për përshtatje, meremetime dhe punime të vogla nga Zyra e Urbanistikës së Bashkisë Librazhd, konfirmuar nga Kryetari i Këshillit të Rrethit;
- vi. skicë e objektit dhe shënime nga Zyra e Urbanistikës së Bashkisë Librazhd;
- vii. aktkolaudim nr. ***prot., datë 8.6.1999, përgatitur nga Seksioni i Urbanistikës, Këshilli i Rrethit Librazhd;
- viii. kontratë shitblerje nr. ***, datë 8.5.2001, trualli me sip. 25 m², me çmim shitjeje 50.000 lekë, palë shitëse Z. K.;
- ix. vendim nr. ***, datë 30.7.2004, i KRRT-së Librazhd, për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij; sip. e sheshit 163 (138+25) m² dhe sip. e ndërtimit 143 m²;
- x. leje ndërtimi në emër të subjektit ndërtues "H." sh.p.k., miratuar me vendim nr. ***, datë 8.10.2004, të KRRT-së, me objekt "ngritje kati e banesës ekzistuese, plus çati të shfrytëzueshme, plus shtesë";
- xi. aktkolaudimi i datës 9.2.2006, përgatitur nga kolaudator privat, sipas të cilit kati i parë ka sipërfaqe 143 m² dhe kati i dytë (nën çati) ka sipërfaqe 90 m², kurse kati përdhes është ekzistues; shoqëria ndërtuese sipas këtij akti është "H." sh.p.k.;
- xii. preventiv i përgatitur nga inxhinier i pavarur, sipas të cilit kostoja për ngritje kati plus çati është 1.965.960 lekë².

25. Nga analiza e përgjigjeve të institucioneve dhe të dokumentacionit të administruar ka rezultuar se ZVRPP-ja Librazhd konfirmon pasurinë nr. ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, truall me sip. 163 m² (që vjen si bashkim i dy pjesëve 138 m² dhe 25 m²), nga e cila sip. 119.5 m² ndërtim.

26. Nëpërmjet deklaratës noteriale nr. ***, datë 14.2.2015, shtetasit A. K., K. K. dhe S. Q., deklarojnë se:

- i. Z. Sulejman Kurti është ndarë nga trugu familjar në vitin 1993 pa marrë asnjë lloj pasurie nga familja.
- ii. Z. A. K., së bashku me djalin K. K. dhe z. Sulejman nga viti 1993, në mënyrë artizanale, kanë prodhuar 14.000 tulla, dy furra me gëlqere dhe kanë grumbulluar inerte në lumë (gurë, zhavorr dhe rërë).
- iii. Transportin e materialeve e ka bërë z. S. Q., kurse për ndërtimin, përveç familjarëve, i ka ndihmuar specialisti i ndërtimit, z. B. C.

² Përveç këtij preventivi nuk ka asnjë faturë apo dokument tjetër që të provojë koston reale të ndërtimeve në fjalë.

- iv. Përveç ndihmës fizike i kanë dhënë edhe 200.000 lekë të përfituara nga pushkatimi pa gjyq i z. S. K. (gjyshi i subjektit).
27. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar vlerën 1.800.000 lekë të pasurisë truall me sip. 138 m² dhe ndërtesë me sip. 92 m², si dhe vlerën 50.000 lekë të pasurisë truall me sip. 25 m².
28. Në pyetësonin nr. 2, datë 4.3.2019, subjekti deklaroi sipërfaqen e ndërtimit 91 m² dhe koston totale për ndërtimin e katit përdhes në vlerën 410.000 lekë.
29. Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ZVRPP-ja Librazhd sipërfaqja e katit përdhes rezultoi 94.5 m².³
30. Sipas dokumenteve të administruar nga ZVRPP-ja Librazhd dhe atyre të vënë në dispozicion në pyetësor nga subjekti, kati përdhes i kësaj pasurie është ndërtuar në vitet 1997-1998, ndërkohë që subjekti është bërë pronar i ligjshëm i truallit në vitin 1999, pas përfundimit të ndërtimit⁴.
31. Për regjistrimin e kësaj pasurie (ndërtimit) në ZVRPP, subjekti ka disponuar një leje ndërtimi të datës 27.5.1998, për përshtatje, meremetime dhe punime të vogla – rrethanë kjo që konfirmon ekzistencën e një objekti para kësaj date.
32. Sipas aktit të kolaudimit nr. *** prot., datë 8.6.1999, të përgatitur nga Seksioni i Urbanistikës, Këshilli i Rrethit Librazhd, objekti është ndërtuar në përputhje me lejen e ndërtimit datë 27.5.1998, ndërkohë që rezultoi se leja në fjalë është dhënë vetëm për përshtatje, meremetime dhe punime të vogla dhe jo për një ndërtim të ri.
33. Nga kontrata e shitblerjes së truallit me nr. ***, datë 14.4.1999, me palë shitëse Bashkia Librazhd, me objekt sipërfaqe truall 138 m², rezultoi një çmim shitjeje prej 66.240 lekësh, ose 480 lekë/m², ndërsa në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 8.5.2001, me palë shitëse Z. K., për sipërfaqen e truallit 25 m², çmimi i shitjes rezultoi në vlerën 50.000 lekë, ose 2.000 lekë/m², ndërkohë që sipas dokumentit të rivlerësimit të përdorur në vitin 2011 çmimi i referencës në vitin 1999 në këtë zonë ka qenë 10.500 lekë/m².
34. Sipas deklaramentit në deklaratën “Vetting” kjo pasuri ka vlerën e akumuluar 3.785.960 lekë, ndërkohë që:
- i. Në deklarimin e pasurisë në vitin 2003 vlera e deklaruar e kësaj pasurie (truall me sip. 138 m² dhe sip. ndërtimi mbi të 92 m²) është në vlerën 1.800.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër e truallit me sip. 25 m² është blerë në vlerën 50.000 lekë.
 - ii. Në deklarimin periodik të pasurisë në vitin 2005 vlera e deklaruar e punimeve për shtesë kati, plus çati të shfrytëzueshme, plus punime shtesë është 1.965.960 lekë.
 - iii. Në pyetësonin nr. 2, datë 4.3.2019, subjekti shpjegon se vlera për ndërtimin e katit përdhes dhe blerjen e truallit është vetëm 476.240 lekë.
 - iv. Vlera e pasurisë sipas rivlerësimit të kryer nga ZVRPP-ja Librazhd, me kërkesë të subjektit në datën 15.12.2011, është 16.601.100 lekë, përllogaritur në bazë të çmimeve minimale fiskale.
 - v. Në përllogaritjen e tatimit për t’u paguar në vlerësimin e kryer në vitin 2011, si vlerë e përllogaritur për koston e ndërtimit është përdorur kostoja minimale në kohën e

³ Sipas regjistrimit të kësaj pasurie në vitin 1999.

⁴ Në pyetësonin nr. 5, datë 26.6.2019, subjekti është pyetur për këtë dhe sqaron: “Në vitin 1993 kam qenë i punësuar pranë Drejtorisë së Bujqësisë Librazhd kur jam pajisur me një autorizim nga pushteti vendor i kohës dhe kam poseduar një objekt, i cili është ngritur në vitin 1970 si kantier strehimi për vullnetarët që kanë punuar në ndërtimin e hekurudhës. Ndërtimi ka qenë provizor, ndërtuar me skelet kapriatë dërrasë dhe mbuluar me eternit, por i pa regjistruar si pronë. Në këtë objekt kam jetuar në vitet 1993 - 1998, kur jam pajisur me leje për rikonstrukcion të çatisë, por gjatë kryerjes së punimeve aksidentalisht objekti u shemb dhe unë jam detyruar të kryej ndërtimin nga e para.”

ndërtimit (pasi nuk ka kontratë shitjeje), e cila rezulton të jetë 9.864.165 lekë vetëm ndërtimi.

35. Sipas deklaramit në deklaratën “Vetting” kjo pasuri ka sip. ndërtimi 119.5 m², ndërkohë që sipas dokumenteve të vendosura në dispozicion nga ZVRPP-ja Librazhd rezulton se kjo pasuri, duke i konsideruar të tre katet e ndërtesës, ka sip. ndërtimore totale 352.5 m².

36. Për ndërtimin e kryer në vitin 2005, subjekti disponon leje ndërtimi në emër të subjektit ndërtues “H.” sh.p.k. (me investitor subjektin e rivlerësimit), miratuar me vendim nr. ***, datë 8.10.2004, të KRRT-së, me objekt “ngritje kati e banesës ekzistuese, plus çati të shfrytëzueshme, plus shtesë”, konfirmuar nga aktkolaudimi i datës 9.2.2006 dhe vërtetim nga Dega e Tatimeve⁵, dokumente të përdorura për regjistrimin në hipotekë të kësaj pasurie.

37. Në pyetësin nr. 2, datë 4.3.2019, subjekti ka deklaruar se nuk kanë pasur marrëdhënie me këtë shoqëri dhe emri saj është përmendur gabimisht në aktkolaudimi. Ndërkohë që pjesë e dosjes së aplikimit të kryer nga subjekti është edhe vërtetimi i datës 21.12.2006, i Degës së Tatimeve, çka duket se konfirmon ekzistencën dhe vazhdimin e marrëdhënies së subjektit me këtë shoqëri.

38. Për të mundësuar një paraqitje sa më të qartë të analizës dhe faktit që ndërtimi i kësaj banese është kryer në dy faza, në lidhje me burimet e përdorura, analiza është kryer e ndarë në dy periudha:

39. Lidhur me ndërtimin i katit të I-rë në vitin 1998:

- i. Në deklarimin e pasurisë në vitin 2003, subjekti deklaroi si burime financimi për ndërtimin e kësaj banese të ardhura familjare.
- ii. Në pyetësin nr. 2, datë 4.3.2019, subjekti sqaron se për ndërtimin e kësaj banese ka përdorur të ardhurat si më poshtë:
 - a. kursime të subjektit dhe të bashkëshortes ndër vite, pa përcaktuar ndonjë vlerë;
 - b. të ardhura nga emigracioni në Greqi, për rreth dy muaj, në vlerën 100.000 lekë, por nuk ka vënë asnjë dokument në dispozicion që të provojë burimin e ligjshëm të kësaj shume;
 - c. të ardhura përfituar nga babai dhe halla⁶, si pasojë e pushkatimit pa gjyq të gjyshit, por për këtë subjekti nuk ka vënë në dispozicion ndonjë dokument që të provojë sa ka qenë shuma e përfituar nga ky dëmshpërblim në vlerën 200.000 lekë.
- iii. Subjekti ka deklaruar se ka prodhuar në mënyrë artizanale 14.000 copë tulla, gëlqere, si dhe ka grumbulluar inertet e përdorura vetë dhe me ndihmë nga të afërmit e tij, që kanë kryer edhe punën e krahut dhe kanë dhënë asistencë teknike.
- iv. U morën në shqyrtim të ardhurat e krijuara nga subjekti dhe bashkëshortja për periudhën 1992 – 1998, sipas vërtetimeve nga punëdhënësit përkatës, të cilat kanë rezultuar në vlerën 1.200.996 lekë. Kjo vlerë është konfirmuar edhe nga përlllogaritjet e kryera nga vetë subjekti i rivlerësimit, të përcjella pranë Komisionit me përgjigjet e pyetësin nr. 2, datës 4.3.2019.
- v. Shpenzimet jetike për këtë periudhë janë llogaritur në vlerën 644.836 lekë.⁷
- vi. Në mënyrë të përmbledhur, në tabelën e mëposhtme, janë paraqitur të ardhurat, shpenzimet dhe investimet e kryera përgjatë periudhës 1992 – 1998:

⁵ Vërtetimi datë 21.12.2006, nga Dega e Tatimeve kërkohet nga ZVRPP-ja për të provuar që subjekti ndërtues nuk ka detyrime ndaj administratës tatimore për objektin e ndërtuar dhe për të cilin aplikohet për regjistrim.

⁶ Shihni deklaratën notoriale me nr. ***, datë 14.2.2015.

⁷ Për periudhën deri në vitin 1995 janë konsideruar si shpenzime 70% e të ardhurave të provuara, kurse për vitet 1996 – 1998 shpenzimet jetike janë llogaritur 5.000 lekë në muaj për person.

Përshkrimi	Vlera e ndërtimit sipas EKB-së⁸
Ndërtimi i banesës, kati i I-rë	-1.875.510
Shpenzime jetese	-644.836
Të ardhura nga emigracioni	0 ⁹
Të ardhura nga dëmshpërblimi	200.000
Të ardhura nga punësimi	1.200.996
Rezultati	-1.119.350

40. Nga sa më lart ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme financiare për të përballuar shpenzimet e jetesës dhe për ndërtimin e katit të parë të kësaj pasurie – pasi nga analiza financiare për periudhën në fjalë rezulton një vlerë negative prej 1.119.350 lekësh.

41. Lidhur me ndërtimin e katit të II-të të kësaj ndërtese, si dhe me shtesën anësore/horizontale dhe vertikale (kati nën çati), të kryer në këtë pasuri në vitin 2005, ka rezultuar se në deklarinim periodik vjetor të vitit 2005 subjekti deklaroi se ka shpenzuar rreth 2.000.000 lekë për ndërtimin e banesës (shtesë kati, shtesë për shkallët dhe çati të shfrytëzueshme), por nuk ka deklaruar burimin e kësaj shume.

42. Në preventivin e punimeve përgatitur nga inxhinier Gj. P., me nr. licence ***, (preventivi rezulton se nuk ka datë), vlera e disa punimeve është parashikuar në shumën prej 1.965.960 lekësh.

43. Gjithashtu nga deklarimi periodik vjetor i vitit 2005, ka rezultuar se subjekti:

- i. nuk ka deklaruar ndryshime të gjendjes së kursimeve *cash*;
- ii. ka deklaruar marrje të një huaje nga kunati i tij, z. B. B. (në momentin e fillimit të punimeve për ngritjen e katit, mars 2005), në vlerën 1.000.000 lekë;
- iii. ka deklaruar se ka marrë një tjetër hua nga i vëllai, z. K. K., në vlerën 500.000 lekë, në qershor 2005;
- iv. ka deklaruar marrje kredie në “Raiffeisen Bank”, në datën 21.9.2005, në vlerën 400.000 lekë.

44. Në deklarinimet periodike për vitet 2004 dhe 2005 subjekti nuk ka deklaruar ndryshime të gjendjes *cash*, por në pyetësin nr. 2, datë 4.3.2019 subjekti ka sqaruar se nga shuma prej 1.000.000 lekësh të deklaruara *cash* në vitin 2003, shuma prej 200.000 lekësh është përdorur për blerjen e automjetit në vitin 2004 dhe pjesa tjetër, pra, shuma e mbetur prej 800.000 lekësh, është përdorur në vitin 2005 për kryerjen e punimeve ndërtimore.

45. Pasi u analizuan rrethanat dhe kushtet e huas prej 1.000.000 lekësh, marrë pa afat dhe pa interes nga znj. L. dhe z. B. B., në vitin 2005, subjekti është pyetur në pyetësin nr. 3, datë 2.4.2019, në përgjigje të të cilit, lidhur me marrëdhënien me huadhënësit, ka sqaruar se znj. L. B. është motra e tij dhe se z. B. B. është kunati i tij (burri i motrës). Gjithashtu, subjekti në pyetësin nr. 5, datë 26.6.2019, lidhur me mënyrën e transferimit të parave, ka sqaruar se

⁸ Duke marrë në konsideratë vlerat e parashikuara në VKM-në nr. 214, datë 28.4.1999, për zonën/xytetin e referencës, si dhe jurisprudencën e Kolegjit të Apelit, lidhur me përlllogaritjen e këtyre shpenzimeve, në mungesë të provave shkresore/ligjore të kundërta.

⁹ Duket se shpjegimet e dhëna nga subjekti mbeten të paprovuara me dokumente ligjore lidhur me burimin e ligjshëm të shumës prej 100.000 lekësh – të pretenduara nga punësimi në emigracion dhe të pavërtetuara/provuara në kuptimin e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016.

shuma e kësaj huaje prej 1.000.000 lekësh, është marrë në dorë *cash* në muajin mars të vitit 2005.

46. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se kunati i tij (z. B. B.) është emigrant në Greqi që nga viti 1992, por e ka formalizuar qëndrimin e tij që nga viti 1998. Për të provuar burimin e të ardhurave të z. B. B., subjekti ka vënë në dispozicion dokumente të lëshuara nga shteti grek – të përkthyer dhe të pajisura me vulë apostile – nga ku rezulton se Ministria e Financave të Greqisë vërteton nëpërmjet “pasqyrës së të dhënave të likuidimit të detyrimeve tatimor personale bazuar në deklarinimin fillestar”, se për vitet 2003 – 2006 z. B. B. ka realizuar të ardhura të tatuara në total 12.900 euro, siç është detajuar në tabelën më poshtë:

Viti	Shuma e të ardhurave në euro
2003	2.700
2004	4.200
2005	3.000
2006	3.000
TOTAL	12.900

47. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të lartpërmendur, shprehet se nga z. B. janë paguar 12.600 euro për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, për pasojë të ardhurat kanë qenë shumë më të mëdha, ndërkohë, sipas përshtimit të këtyre shkresave, të përkthyer në shqip, rezulton se shuma 12.900 euro, ka qenë totali i të ardhurave.

48. Në pyetësin nr. 7, datë 4.10.2019, subjekti sqaron se bashkëshortja dhe fëmijët e z. B. B. kanë jetuar në Shqipëri, në fshat, ndërsa z. B., në këto vite që ka jetuar dhe punuar në Greqi, ka banuar në shtëpinë e punëdhënësit.

49. Gjithashtu, subjekti ka vendosur në dispozicion vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sipas të cilit znj. B. ka derdhur kontributet si person i vetëpunësuar në bujqësi.

50. Komisioni, pasi mori në analizë huan prej 500.000 lekësh që subjekti ka marrë, pa afat dhe pa interes nga shtetasit M. dhe K. K., në vitin 2005, ka pyetur subjektin e rivlerësimit në pyetësin nr. 3, datë 2.4.2019, lidhur me këto rrethana. Nëpërmjet përgjigjeve të këtij pyetësi subjekti ka shpjeguar se z. K. K. është vëllai i tij dhe se shuma prej 500.000 lekësh i është dhënë/dorëzuar në *cash* në qershor 2005, nga kunata e tij, znj. M. K. – me pëlqimin paraprak të bashkëshortit të saj.

51. Lidhur me burimin e të ardhurave të vëllait të tij në Greqi, subjekti ka vënë në dispozicion dokumente nga shteti grek – të përkthyer dhe të pajisura me vulë apostile – nga ku rezulton se Ministria e Financave të Greqisë vërteton nëpërmjet “pasqyrës së të dhënave të likuidimit të detyrimeve tatimor personale bazuar në deklarinimin fillestar”, se për vitet 2002 – 2006 z. K. K. ka realizuar të ardhura të tatuara në total 24.581 euro, siç është detajuar në tabelën më poshtë:

Viti	Shuma e të ardhurave në euro
2002	2.064
2003	4.430
2004	5.946
2005	6.031
2006	6.110

TOTAL	24.581
--------------	---------------

52. Gjithashtu subjekti, në përgjigje të pyetësorit të sipërcituar, shprehet se për vitet 2002 – 2005 z. K. K. ka paguar 18.471 euro për sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe për pasojë të ardhurat kanë qenë shumë më të mëdha, ndërkohë, sipas përshkrimit të shkresave (të përkthyer në shqip) rezulton se shuma 18.471 euro ka qenë totali i të ardhurave për këtë periudhë.

53. Nga shqyrtimi i llogarive bankare ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në datën 31.12.2004, nuk ka pasur gjendje monetare të depozituar, ndërsa në datën 31.12.2005 gjendja në llogarinë bankare ka qenë në shumën 5.106 lekë.

54. Të ardhurat nga punësimi i subjektit të rivlerësimit dhe i bashkëshortes së tij, sipas vërtetimeve të punësimit për vitin 2005, kanë qenë në vlerën 1.142.140¹⁰ lekë.

55. Nga shqyrtimi i deklarimeve të subjektit në deklaratimet periodike, si dhe përgjigjet e tij në pyetësorin nr. 2, datë 4.3.2019, nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar shtesa në gjendje *cash* më 31.12.2004 – nga kursimet familjare të gjeneruara përgjatë vitit 2004 – të cilat mund të ishin përdorur në vitin 2005 për kryerjen e punimeve të pasurisë në fjalë. Në deklaratimin e vitit 2005, subjekti deklaron të ardhura nga qiraja në vlerën 100.000 lekë¹¹.

56. Në mënyrë të përmbledhur, në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar të ardhurat, shpenzimet dhe investimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, përgjatë vitit 2005.

Përshkrimi	Shumat në lekë
Ndërtim shtesë banese, sip. 261.5 m ² (233 + 28.5)	-6.551.621 ¹²
Gjendje në bankë	-5.106
Shpenzime ¹³	-781.593
Të ardhura nga punësimi	1.142.140
Përdorim i kursimeve <i>cash</i>	800.000
Kredi “Raiffeisen Bank”	348.672 ¹⁴
Hua, L. & B. B.	1.000.000
Hua, M. & K. K.	500.000
Të ardhura nga qiraja	100.000
Rezultati	-3.447.508

57. Në këtë vit janë marrë në konsideratë edhe të ardhurat prej 100.000 lekësh, me burim fitimet nga dhënia me qira e pasurive të tij. Kjo, pasi subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja gjatë periudhës 2005 – 2016, të cilat janë konsideruar në analizën financiare, të përgatitur nga Komisioni – (edhe pse ato janë përfutur në mungesë të kontratave shkresore të qirasë dhe pagimi i detyrimeve tatimore nuk është kryer në vitet e referencës) – nga momenti që Drejtoria

¹⁰ Të deklaruar në DPV-në e vitit 2005 janë në shumën 1.073.344 lekë.

¹¹ Subjekti nuk ka pasur kontratë të shkruar me qiramarrësin në vitin 2005, nuk ka deklaruar/paguar detyrime tatimore në momentin e gjenerimit të të ardhurave, por në vitin 2007 ka një deklaratë noteriale sipas së cilës është paguar shuma në fjalë si qira. Kurse në vitin 2016 është kryer pagesa e detyrimeve tatimore për të gjithë periudhën duke filluar nga viti 2005.

¹² Vlera e kostos së ndërtimit, përllogaritur në bazë të Udhëzimit Nr. 5, datë 23.11.2005 të Këshillit të Ministrave, është 25.054 lekë/m².

¹³ Përllogaritur për vitin 2005 sipas shkresës nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së, shpenzime jetese 547.785 lekë dhe shpenzime udhëtimi dhe interesa kredie 33.088 lekë.

¹⁴ Kredia e marrë ka vlerën prej 400.000 lekë, por 51.328 lekë janë komisione bankare dhe pagesa të principalit për vitin 2005.

Rajonale e Tatimeve, me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2019, është shprehur se mbi këto të ardhura, nga subjekti i rivlerësimit rezultojnë të paguara të gjitha detyrimet tatimore (përfshirë: principalin, kamatëvonesat dhe penalitetet për deklarimin/pagesën e vonuar), edhe për vitet e mëparshme (mbi shumën e të ardhurave, për një total prej 2.880.000 lekësh).

58. Në bazë të analizave të sipërcituara në lidhje me burimet e përdorura për këtë pasuri rezultoi se subjekti nuk kishte mjaftueshëm burime financiare të ligjshme, pasi është konstatuar një mungesë totale prej **4.566.858** lekësh, dhe përkatësisht:

- i. shuma prej - 1.119.350 lekësh për ndërtimin e katit të parë në vitin 1998;
- ii. shuma prej - 3.447.508 lekësh për ndërtimin e katit të dytë, çatisë dhe shtesës në vitin 2005.

59. Për sa më lart, lidhur me këtë pasuri, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit lidhur me gjetjet/rezultatet e mëposhtme:

- *duket se ka mospërputhje midis deklaratës “Vetting” dhe deklarimeve të tjera apo konstatimeve nga dokumentet e administruara nga Komisioni, lidhur me sipërfaqen totale të banesës trekatëshe, në pronësi të subjektit;*
- *duket se ka mospërputhje midis deklarimeve të subjektit dhe dokumenteve të administruara nga Komisioni, në lidhje me vlerën e pronës në fjalë dhe mbi kostot e ndërtimit të saj;*
- *nga analiza financiare, që ka përgatitur Komisioni, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në vlerën totale 4.566.858 lekë, për ndërtimin e kësaj pasurie.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

60. Lidhur me rezultatet e arritura nga Komisioni mbi pasurinë e analizuar më lart, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar si vijon:

- i. Në deklarimin e bërë në deklaratën “Vetting” nuk janë evidentuar huat, kreditë, ndihmat e familjarëve, por kjo ka ndodhur për faktin se vetë formulari i deklarimit nuk e kërkonte një gjë të tillë. Në këtë formular kërkoheshin të deklaroheshin vetëm detyrimet e pashlyera, vetëm për pjesën e pashlyer të tyre, ndërkohë që këto detyrime, në momentin e plotësimit të deklaratës për këtë qëllim, nuk ekzistonin, pasi ishin të shlyera tërësisht me të ardhurat familjare të ligjshme të subjektit.
- ii. Çmimi i referencës është për efekt të tatimeve që duhen paguar nga subjektet përkatëse ndërtuese. Ai praktikisht ka qenë herë më i ulët, herë i barabartë dhe herë dukshëm më i lartë, krahasuar me çmimin real të tregut, çmim të cilit i nënshtrohem si subjekte shitëse apo blerëse të pasurive të paluajtshme. Çmimi i referencës mbetet orientues, por i detyrueshëm për palët që shesin dhe blejnë pasuri, por nuk duhet të penalizojë atë që as ka shitur e as ka blerë, por ka ndërtuar me forcat e veta, bazuar në çmimet reale të tregut dhe jo të referencës, e ka prodhuar vetë bazën materiale për ndërtimin e shtëpisë (tulla, gëlqere, inerte etj.), për të vetmen arsye se nuk ka mundësi financiare për të blerë një shtëpi. Duke shtuar se nuk disponohen dokumente ligjore për të ardhurat nga emigracioni në shumën 100.000 lekë.
- iii. Lidhur me shpenzimet për ndërtimet, të cilat sipas analizës rezultojnë më të vogla se çmimet minimale fiskale, subjekti është shprehur se kostoja e ndërtimeve në fjalë del më e vogël se kostoja e ndërtimit sipas të dhënave të Entit Kombëtar të Banesave, për të vetmen arsye se ndërtimet kanë si kosto vetëm më pak se gjysmën e bazës materiale të përdorur për ndërtimin e tyre (vetëm hekur e çimento), pasi më shumë se gjysma e materialeve të ndërtimit (tulla, gëlqere, inerte etj.), janë prodhuar nga subjekti dhe familjarët në mënyrë artizanale, si dhe për dyert dhe dritaret janë përdorur dërrasat e kapriatave të

- barakës ku ka jetuar, përfshirë këtu edhe të gjithë vlerën e punës së krahut, pasi ndërtimin e ka bërë vetë subjekti.
- iv. Çmimet reale të blerjes së banesave (jo kostot e ndërtimit) për periudhën që janë bërë ndërtimet (vitet 1997 - 1998 dhe viti 2005) kanë qenë rreth 900.000 lekë, për një banesë 2+1 me sipërfaqe aq sa është edhe sipërfaqja e ndërtimit (shihni çmimet reale të shitblerjes së banesave në Librazhd për periudhën 1998 dhe 2005, që përkon me kohën kur janë bërë ndërtimet dhe kontratat që janë vënë në dispozicion janë: kontratë shitblerje banese nr. ***, datë 6.3.1998; kontratë shitblerje banese nr. ***, datë 6.3.1998; kontratë shitblerje banese nr. ***, datë 4.3.1998; kontratë shitblerje banese nr. ***, datë 15.6.2005; kontratë shitblerje banese nr. ***, datë 7.6.2005; kontratë shitblerje banese nr. ***, datë 18.7.2005; kontratë shitblerje banese nr. ***, datë 6.9.2005, të marra nga arkiva e ZVRPP-së Librazhd, nga të cilat rezulton se çmimi mesatar i shitjes për një sipërfaqe të barabartë me ndërtimin ka qenë 900.000 lekë për banesë, afërsisht më pak se 10.000 lekë/m², ndërkohë që kostoja sipas EKB-së ka qenë 27.878 lekë/m²).
 - v. Lidhur me faktin se nuk disponohen faturat e blerjes së materialeve të ndërtimit, subjekti sqaron se askush nuk e mendonte se do të vinte një ditë, pas kaq shumë vitesh, që të kërkoheshin këto fatura. Nuk ka pasur ndonjë normë ligjore detyruese për ta bërë një gjë të tillë dhe që nuk e ka zbatuar, pasi të gjitha deklaratimet periodike të pasurisë të bëra ndër vite nuk e kanë kërkuar një gjë të tillë, të cilat nuk kanë kërkuar atëherë dhe as aktualisht prova që të shoqërojnë deklaratimet (subjekti sqaron se as institucionet shtetërore nuk i ruajnë të gjitha dokumentet përgjithmonë, por edhe ato kanë një afat të caktuar kohor, përgjithësisht 10 vjet, ndërkohë që ndërtimi përkon me një periudhë para 22 vitesh dhe për më tepër në një shtet tërësisht informal në atë periudhë).
 - vi. Për katin e parë, vlera 1.820.000, e deklaruar nga subjekti, sipas tij nuk përfaqëson shpenzimet e tij për këtë ndërtim, por vlerën e tregut të banesës, e llogaritur apriori në aktin e vlerësimit përkatës, të cilin ua vë në dispozicion. Preventivi i paraqitur e konfirmon një fakt të tillë plotësisht. Bashkëlidhur është paraqitur një preventiv për ndërtimin e katit të parë, i bërë nga një ekspert i licencuar në tetor të vitit 2019.
 - vii. Lidhur me faktin se kush e ka ndërtuar ngritjen e katit, subjekti shprehet se kontrata me shoqërinë “H.” sh.p.k., është përdorur vetëm për të nxjerrë lejen e ndërtimit, ndërsa ndërtimi është bërë nga ai vetë si investitor, kjo për arsyen se me shoqërinë “H.” sh.p.k., nuk ishte rënë dakord për çmimet e punimeve që do të kryente, afatin e ndërtimit, për rrjedhojë, kontrata nuk është ekzekutuar nga kjo shoqëri. Këtë fakt e ka deklaruar edhe përfaqësuesi ligjor i kësaj shoqërie në deklaratën noteriale nr. ***, datë 5.3.2019. Ngritja e katit është bërë nga vetë subjekti me ndihmën e babait të tij, A., vëllait, K., të drejtuar dhe asistuar nga një specialist ndërtimi, shtetasi B. C.

Vlerësimi i Komisionit

61. Lidhur me mospërputhjet e të dhënave të dokumentacionit të administruar nga Komisioni me deklaratimet e subjektit, mbi sipërfaqen e pasurisë në fjalë, trupi gjykues vlerëson se edhe pas shpjegimeve të subjektit, ato mbeten të tilla. Duke pasur në konsideratë përmbajtjen e prapësimeve të subjektit, i cili shprehet se këto mospërputhje apo deklarime të pasakta nuk kanë pasur për qëllim kryerjen e ndonjë fshehjeje, duhet qartësuar fakti se Komisioni në asnjë moment nuk ka konkluduar në këtë mënyrë, por ka evidentuar mospërputhjet e konstatuara nga hetimi administrativ – të cilat në vetvete, në këtë rast, për peshën specifike që mbartin, nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm për marrjen e një mase disiplinore. Gjithsesi, ato do të konsiderohen nga Komisioni në një vlerësim tërësor të çështjes.

62. Trupi gjykues, lidhur me mospërputhjet e të dhënave të dokumentacionit të administruar nga Komisioni me deklaratimet e subjektit, mbi sipërfaqen e pasurisë në fjalë, vlerëson se edhe pas shpjegimeve të subjektit ato mbeten të tilla. Duke pasur në konsideratë përmbajtjen e

prapësimeve të subjektit, i cili shprehet se këto mospërputhje apo deklarime të pasakta nuk kanë pasur për qëllim kryerjen e ndonjë fshehjeje, Komisioni në asnjë moment nuk ka konkluduar në këtë mënyrë, por ka evidentuar mospërputhjet e konstatuara nga hetimi administrativ, të cilat në vetvete, në këtë rast, për peshën specifike që mbartin, nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm për marrjen e një mase disiplinore, fakt që do të mbahet në konsideratë gjatë vlerësimit tërësor të çështjes.

63. Për sa i përket kostos së ndërtimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit në vitet 1998 dhe 2005, nëpërmjet një analizimi dhe një vlerësimi tërësor të fakteve, deklarimeve dhe përgjigjeve të subjektit, si dhe të rrethanave të tjera, trupi gjykues çmon se vlera e kostos së ndërtimit të kësaj pasurie të deklaruar nga subjekti, nuk mund të konsiderohet se është vlera reale e saj, në bazë të të cilës mund të realizohet analiza financiare. Trupi gjykues arrin në përfundimin se vlerat e pretenduara nga vetë subjekti, si dhe preventivi pjesë e akteve apo aktekspertimi i kryer nga eksperti (i licencuar) i zgjedhur nga subjekti, nuk bazohen në dokumente ligjore apo në referenca ligjore, metodologji, apo standarde zyrtare të njohura që mund të provojnë vërtetësinë e deklarimeve dhe pretendimeve të tij – të ndërtimeve të kryera me kosto disa herë më të ulët se ato që rezultojnë në kohën e ndërtimeve të kryera në këtë pasuri, bazuar në parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore që i referohen Entit Kombëtar të Banesave. Për sa më lart, trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave është bazuar në kostot mesatare vjetore të shfrytëzimit, sipas përcaktimeve në vendimet dhe udhëzimet e Entit Kombëtar të Banesave, të cilat në parashikimet e tyre kanë përfshirë edhe vlerën e kostove për vitet 1998 dhe 2005, në të cilët ka ndërtuar subjekti i rivlerësimit. Në këto përlllogaritje janë mbajtur në konsideratë sipërfaqet e ndryshme të ndërtuara për secilin vit, sipas deklarimit të subjektit, të cilat, duke u shumëzuar me koston mesatare të ndërtimit për m², japin koston totale të ndërtimit për çdo vit.

64. Komisioni vlerëson se për sa kohë që në dokumentacionin e administruar lidhur me kostot e ndërtimeve në fjalë nuk rezulton asnjë dokument ligjor që mund të provojë koston e tyre, duhet të aplikohen kostot e referencës të EKB-së. Preventivi i shoqërisë “H.” sh.p.k., nuk mund të ketë vlerën e provës nga momenti që nga njëra anë ai dokument jo vetëm që nuk është një faturë me vlerë provuese mbi punime të kryera realisht, por nuk as nuk është analitik, dhe nuk pasqyron të gjitha sipërfaqet dhe zërat e punimeve që më pas janë kryer realisht. Nga ana tjetër, vetë subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përsëritur, ka deklaruar se shoqëria “H.” sh.p.k., nuk ka kryer asnjë punim në këtë pasuri – por emri dhe preventivi i saj janë përdoruar nga subjekti për të mundësuar marrjen e lejes së ndërtimit në vitin 2005. Po ashtu, Komisioni nuk e konsideron si një provë ligjore dhe as bindëse aktin e ekspertit (ing. Gj. P.), të përzgjedhur nga subjekti, të përgatitur dhe paraqitur përgjatë procesit të rivlerësimit (tetor 2019), për sa i përket kostos së ndërtimit të kryer në vitin 1998.

65. Lidhur me aplikimin e çmimeve/kostove të referencave, sipas parashikimeve të EKB-së – në mungesë të provave ligjore të kundërta, siç është rasti konkret – trupi gjykues ka mbajtur në konsideratë edhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, tashmë të konsoliduar mbi këtë pikë diskutimi, si në vendimin nr. 15/2019¹⁵, - i cili lidhur me një rrethanë të ngjashme me

¹⁵ Ku veç të tjerash shprehet se: “[...] Kolegji vlerëson të drejtë qëndrimin e mbajtur prej Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të provuar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij, në këtë rast të lidhura ngushtë me vlerën që do të pranohet se ka pasuria banesë në rrugën “{***}” Tiranë. Ky detyrim buron nga parashikimi i nenit Ç, pika 5 dhe nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si edhe nenit 32, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, por pavarësisht kësaj subjekti nuk ka paraqitur as bashkëlidhur deklaratës së pasurisë “Vetting” dhe as përgjatë hetimit administrativ, dokumentacion justifikues i cili do të provonte deklaratimet e tij për vlerën e kësaj pasurie. Në kushtet kur kjo pasuri është krijuar prej tij, subjekti i rivlerësimit në kuptim të këtyre dispozitave të përmendura më lart, kishte detyrimin të provonte vlerën e saj nëpërmjet paraqitjes së dokumentacionit justifikues që do të vërtetonte pagesat e kryera ose të parashikuara se do të

atë që po analizohet këtu, ka vlerësuar si të aplikueshme referencat e kostove të ndërtimit të parashikuara nga ky institucion (EKB), në mungesë të provave të tjera, të ndryshme.

66. Trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë arsyetimet e Kolegjit si më lart, dhe duke vlerësuar faktet dhe rrethanat e rastit në fjalë, pas përllogaritjeve të kryera (sipas kostove të referencës së EKB-së për vitet përkatëse), lidhur me të gjitha ndërtimet e kësaj pasurie, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur aftësi financiare të gjeneruara nga burime të ligjshme, në shumën totale prej 4.566.858 lekësh, pasi ka rezultuar një mungesë prej - 1.119.350 lekësh për ndërtimin e katit të parë në vitin 1998 dhe një vlerë negative prej - 3.447.508 lekësh për ndërtimin e katit të dytë, të katit të tretë (nën çati) dhe të shtesës anësore, në vitin 2005.

67. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se, edhe nëse do të zbritej nga vlera totale e kostove të ndërtimit¹⁶ – të përllogaritura sipas referencave të EKB-së – pjesën që i përket TVSH-së¹⁷ (20%) dhe fondit rezerve (5%) – që përbën pikërisht 25% të kostos totale të ndërtimit – subjekti gjithsesi gjendet me një bilanc negativ për dy vitet objekt analize (1998 dhe 2005), me një mungesë të burimeve financiare në shumën totale prej -3.425.143 lekësh. Për rrjedhojë, trupi gjykues, si konkluzion, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mjaftueshëm burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

68. Së fundmi, për shkak që vijojnë, Komisioni i vlerëson pa vlerë provuese (në kuptimin e analizës logjike të subjektit) shtatë kontratat e shitblerjeve në treg të lirë, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit – që, sipas tij, përbëjnë një tregues kuptimplotë mbi kostot reale të ndërtimeve në qytetin e Librazhdit, në vitet 1998 dhe 2005, shumë më të ulëta se vlerat e referencës së EKB-së që janë marrë në konsideratë në analizën financiare, pasi çmimi i shitjes në këto kontrata është shumë më i vogël se kostoja e ndërtimit të përllogaritur (për subjektin), dhe për rrjedhojë ndërtuesit do të kishin dalë me humbje të theksuara.

69. Trupi gjykues çmon se argumentimi i mësipërm i subjektit të rivlerësimit nuk gjen mbështetje në përmbajtjen e shtatë kontratave të paraqitura prej tij, për sa kohë nga analiza e tyre ka rezultuar se:

69.1 Kontrata nr. *** rep., datë 4.3.1998, pasqyron një shitblerje midis dy shtetasve me të njëjtin mbiemër (F.), të një apartamenti (nr. ***) me sipërfaqe të përafërt/ngjashme me atë që ka ndërtuar subjekti në vitin 1998, me çmim 800.000 lekë. Pallati nr. ***, ku bën pjesë apartamenti objekt i kësaj shitblerjeje rezulton se është ndërtuar në vitin 1986, dhe për rrjedhojë kostoja e ndërtimit të tij nuk mund të jetë pikë referimi krahasimore për ndërtimet e vitit 1998. Për më tepër, pala shitëse e ka përfutur pasurinë në fjalë nëpërmjet privatizimit, me çmim shumë herë më të ulët se çmimi i kësaj kontrate.

69.2 Lidhur me dy kontratat me nr. *** rep., dhe nr. *** rep. të nënshkruara në datën 6.3.1998, vlen i njëjti arsyetim, si në pikën e mësipërme, duke shtuar faktin se efekti juridik final i prodhuar nëpërmjet këtyre dy akteve noteriale, *de facto*, ka qenë shkëmbimi i dy apartamenteve midis palëve (që rezultojnë një herë si shitës dhe pastaj si blerës të apartamenteve respektive, me të njëjtin çmim) dhe jo shitja e mirëfilltë e tyre (që përgjithësisht ka si objektiv realizimin e një përfitimi monetar sa më të lartë). Për më tepër, që pallati (nr. ***) ku ndodhen pasuritë në fjalë është ndërtuar në vitin 1977, jo nga shitësi, dhe për rrjedhojë kostoja e tij e ndërtimit nuk mund të krahasohet me vitin 1998.

kryheshin për ndërtimin e saj, çdo akt shkresor që do të dokumentonte shpenzimet e kryera prej tij apo prej familjarëve për ndërtimin e kësaj banese.[...].

¹⁶ Në analizë financiare është marrë në konsideratë kostoja e ndërtimit – dhe jo referenca e çmimeve të shitjes, nga ku mund të zbritej edhe fitimi i përfutur nga ndërtuesi.

¹⁷ Nga momenti që materialet e përdorura për ndërtimet në fjalë janë paguar nga subjekti (si konsumator final – dhe jo si shoqëri), në çmimin e tyre ka qenë detyrimisht e përfshirë edhe TVSH-ja, për rrjedhojë nuk shihet e arsyeshme përse ky zë nuk duhet të përllogaritet brenda kostove të ndërtimit të një pasurie.

69.3 Për sa i takon kontratës me nr. *** rep., datë 7.6.2005, rezulton se ka për objekt shitblerjen e dy apartamenteve, që së bashku përbëjnë një sipërfaqe 87 m², me çmim një milion lekë – ndërkohë që subjekti i rivlerësimit në vitin 2005 ka ndërtuar një sipërfaqe banimi prej 261 m² (pra 3 herë më të madhe se objekti i kësaj kontrate). Edhe në këtë rast periudha ndërtimore nuk përkon me vitin 2005 (vit për të cilin subjekti e sugjeron si pikë referimi në një analizë logjike mbi kostot e ndërtimit), pasi nga vetë kontrata rezulton se pasuritë janë pajisur me certifikatë pasurie në vitin 2000 (sip. 65 m²) dhe 2003 (sip. 31 m²), për rrjedhojë ndërtimi i tyre ka qenë i disa viteve më parë dhe jo i vitit 2005.

69.4 Lidhur me kontratën nr. *** rep., datë 15.6.2005, rezulton si objekt shitblerjeje një apartament me sip. 73.5 m², me një çmim prej një milion lekësh. Nuk ka të dhëna mbi prejardhjen e kësaj pasurie në favor të shtetasit, që është palë shitëse.

69.5 Ndërsa, në kontratën nr. *** rep., datë 18.7.2005, rezulton si objekt shitblerjeje një apartament me sip. 71 m², me çmim 500.000 lekë. Nuk ka të dhëna mbi prejardhjen e kësaj pasurie në favor të shtetasit që është palë shitëse – por nga teksti i kontratës në fjalë rezulton se certifikata e pronësisë është përfituar më 19.7.2005 (pra një ditë më pas nga data e kontratës së shitblerjes – ndoshta ka një lapsus).

69.6 Edhe në kontratën nr. *** rep., datë 6.9.2005, rezulton si objekt shitblerjeje një apartament me sip. 68 m², me një çmim prej 700.000 lekësh. Nuk ka të dhëna mbi prejardhjen e kësaj pasurie në favor të shtetasit, që është palë shitëse, apo mbi vitin e ndërtimit të kësaj pasurie.

70. Trupi gjykues, në konsideratë të sa më lart konkludon se pretendimet dhe analizat e subjektit të rivlerësimit mbeten në nivel deklarativ dhe të pambështetura në prova konkrete dhe ligjore, të cilat qoftë edhe për analogji, mund të kishin çuar në përcaktimin e ndonjë tjetër vlere mesatare të kostos së ndërtimit në qytetin e Librazhdit në vitet 1998 dhe 2005, më të ulët se ajo e përcaktuar nga EKB-ja. Kontratat e sipërpërmendura kanë pasur për objekt tjetërsimi disa pasuri ekzistuese dhe jo ndërtime të viteve kur ka ndërtuar subjekti këtë pasuri. Argumentimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me koston e ndërtimit, do të rezultonte më konsistent nëse kontratat e paraqitura do të kishin pasur për objekt shitblerjeje apartamente të saponëduara dhe të shitura (brenda vitit) nga vetë shoqëria ndërtuese. Vetëm në këtë rast mund të gjente mbështetje logjika, sipas të cilës, kostoja e ndërtimit të apartamenteve do të kishte pasur një vlerë më të ulët se çmimi mesatar i shitjes (nga ndërtuesi), pasi ky i fundit (çmimi) përmbante apo duhej që të mbulonte edhe zërat e tjerë që i shtohen kostos reale të ndërtimit (si p.sh.: TVSH-ja, fondi rezervë dhe fitimi i investitorit). Në rastin konkret nuk rezulton se jemi në rrethana të tilla, pasi dokumentet dhe argumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk rezultojnë që të kenë vlerë provuese, që të mundësojnë marrjen si referencë nga trupi gjykues të një tjetër vlere të kostos së ndërtimit në qytetin e Librazhdit në vitet 1998 dhe 2005 – të ndryshme nga ajo e përcaktuar nga EKB-ja.

❖ **Apartament me sipërfaqe 33.78 m², me vlerë 4.391.400 lekë, ndodhur në “***”, Tiranë**

71. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se kjo pasuri është blerë nëpërmjet kontratës nr. ***, datë 25.9.2010, në vlerën 4.391.400 lekë. Pagesat e kësaj vlere, sipas deklarimeve të subjektit, kanë pasur këto burime financiare:

71.1 shumën prej 980.000¹⁸ lekësh, të përfituar nga kredia bankare;

71.2 shumën prej 1.000.000 lekësh, si dhe shumën 15.000 euro, të cilat janë marrë hua me interes nga dy individë të ndryshëm;

71.3 pjesa tjetër e mbetur është paguar me të ardhurat dhe kursimet e subjektit dhe të bashkëshortes së tij.

¹⁸ Kredi nr. *** për blerje apartamenti në “Raiffeisen Bank” sh.a. në shumën 1.020.000 lekë.

72. Prona në fjalë është regjistruar në emër të subjektit dhe është lëshuar certifikatë nr. ***, datë 21.10.2010, për vërtetim pronësie, e cila ka këto të dhëna: pasuria nr. ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, me adresë: “****”, p. ***, shk. ***, kati ***, ap. **** dhe sipërfaqe 33.78 m².

73. Sipas kontratës së huadhënies nr. ***, datë 1.12.2010, me palë huamarrëse z. Sulejman Kurti dhe huadhënëse znj. L. C., rezulton se para datës 25.9.2010 subjektit i është dhënë shuma prej një milion lekësh, me afat 3-vjeçar dhe me normë interesi sipas normave të depozitave në fuqi në momentin e dhënies.

74. Ndërsa, sipas kontratës së huadhënies nr. ***, datë 30.11.2010, me palë huamarrëse z. Sulejman Kurti dhe huadhënëse z. F. Gj., rezulton se ky i fundit i ka dhënë subjektit në shtator të vitit 2010 shumën 15.000 euro – me afat 3-vjeçar dhe me normë interesi sipas normave të depozitave në momentin e dhënies.

75. Subjekti është pyetur në pyetësorët nr. 2 dhe nr. 5 në lidhje me burimin e shumave të huazuara nga z. F. Gj., dhe në përgjigje janë paraqitur disa nxjerrje llogarish bankare, mandate derdhje/tërheqje, nga ku evidentohen lëvizje fondesh, si edhe dokumentacion provues për burimin në origjinë të shumave në fjalë¹⁹ – nga momenti që ato nuk ishin kursim i huadhënësit, por i dhëndrit të tij (z. K.), që asokohe jetonte dhe punonte në Itali.

76. Në vijim të pyetësorit nr. 7, datë 4.10.2019, subjekti ka sqaruar se shuma e dërguar nga z. K. për z. Gj. ka pasur si qëllim blerjen e një banesë në Shqipëri në emër të z. K., por shuma e dërguar është përdorur pjesërisht për këtë qëllim.

77. Në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni, shuma prej 15.000 euro, që subjekti ka marrë hua nga z. Gj., është konsideruar si e ardhur me burime të ligjshme, pasi subjekti ka dhënë shpjegime të mëtijshme, lidhur me mundësinë e z. K. për të kursyer shumën prej rreth 48.000 euro, që kishte transferuar tek huadhënësi (të ardhurat e të cilit – të dokumentuara në atë periudhë – rezultonin mbi 75.000 euro) si dhe mbi mospërdorimin e të gjithë kësaj shume për qëllimin për të cilin ishin transferuar (për blerje banese) dhe mbi marrëdhënien e subjektit me huadhënësin dhe shkakun e dhënies së kësaj huaje.

78. Gjithashtu, subjekti është pyetur në pyetësorët nr. 2 dhe nr. 5 edhe në lidhje me burimin e fondeve të huadhënëses, znj. L. C., dhe për këtë qëllim ka paraqitur një kontratë shitje pasurie të paluajtshme. Por, nga analizimi i kësaj kontrate rezultoi se ajo është nënshkruar më 12.10.2010 dhe në përmbajtjen e saj përcaktohet se likuidimi është kryer në dorë, në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate. Duke qenë se kjo kontratë është lidhur disa muaj më vonë nga momenti që pretendohet se është marrë huaja – subjekti ka shpjeguar se një pjesë të shumës znj. L. C. e ka marrë më përpara se të nënshkruhej kontrata, kur z. B. C., i cili ka punuar në Greqi, kishte pasur mundësinë e të qenit prezent në Shqipëri – për këtë arsye është paraqitur kopje e faqeve të pasaportës të bashkëshortit të saj.

79. Gjithashtu, subjekti – në konfirmim të faktit se një pjesë e çmimit të shitjes është marrë nga huadhënësjja paradhënie në gusht të vitit 2010 – ka paraqitur një deklaratë noteriale së bashku me kopje të faqeve të pasaportës për të provuar lëvizjet në kufi të z. B. C.. Pas analizimit të përgjigjeve të dhëna nga subjekti në vijim të pyetësorëve dhe vlerësimit të dokumentacionit mbështetës, duket se subjekti nuk ka provuar burimin e ligjshëm për huadhënësen, znj. L. C., për sa i përket shumës specifike të marrë hua dhe të përdorur nga subjekti i rivlerësimit.

¹⁹ Në llogarinë e z. Gj. për periudhën 2006 – 2008 janë transferuar nga shtetasi A. K. (sipas deklarimeve është dhëndri) 48.185 euro, për të cilat është vënë në dispozicion me vulë apostile dhe i përkthyer dokumenti sipas të cilit provohen të ardhurat e tatueshme për vitet 2005 – 2009, në vlerën 74.466 euro.

80. Lidhur me të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes nga paga për vitin 2010, kanë rezultuar në shumën 1.452.228 lekë. Gjithashtu, për vitin 2010 subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja në vlerën 350.000 lekë.

81. Në vijim, paraqitet analiza financiare për vitin 2010 deri në momentin e blerjes së pasurisë në shtator të vitit 2010:

Të ardhura	Janar – shtator 2010
Të ardhura nga paga	1 089 171
Të ardhura nga qiraja	262 500 ²⁰
Kredi bankare	980 000
Hua 1.000.000 lekë, znj. L. C.	0
Hua 15.000 euro, z. F. Gj.	2 082 150
Shpenzime	
Shpenzime udhëtimi	-27 762
Shpenzime jetese	-512 325
Interesa + shpenzime për kredinë	-59 272
Principal kredie	-222 789
Siguracion	-20 000
Blerje apartamenti	-4 391 400
Rezultati	-819 727

82. Nga sa më sipër, lidhur me këtë pasuri subjektit të rivlerësimit i është njoftuar rezultati hetimor pasi duket se, sipas nenit D të shtojcës së Kushtetutës, nuk ka pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie, pasi ka rezultuar me mungesë në vlerën prej 819.727 lekësh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

83. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar dhe dokumentuar rrethanat në të cilat ka marrë huat e shumave të përdorura për këtë pasuri, si më poshtë vijon.

83.1 Lidhur me huan 1 milion lekë, të marrë nga shtetasja L. C. në vitin 2010, subjekti ka pohuar se ka qenë një marrëdhënie huaje reale dhe se shtetasja L. C. ka pasur në dispozicion sasinë e parave të dhënë hua, pasi përveç të ardhurave familjare që ka pasur nga puna e saj dhe e bashkëshortit, në të njëjtën periudhë ka shitur banesën në qytetin e Librazhdit dhe është transferuar familjarisht në Tiranë, ku banon aktualisht. Kësti i parë në shumën 1.000.000 lekë është paguar nga blerësja L. H. në korrik apo gusht të vitit 2010 dhe për këtë arsye shuma e mësipërme e marrë hua nga subjekti në shtator 2010 është e ligjshme dhe duhet të vlerësohet si e tillë. Ky fakt provohet edhe nga deklarata noteriale nr. ***, datë 28.6.2019.

83.2 Lidhur me huan e marrë nga z. F. Gj., subjekti ka sqaruar se shtetasi A. K., është dhëndri i kunatit të subjektit, z. F. Gj. dhe ka punuar si emigrant ekonomik në Itali. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se vetëm në 5 vjet përpara transferimit të shumave në fjalë të ardhurat e tij kanë qenë në shumën 74.466 euro. Nga këto, shuma 48.000 euro është transferuar nëpërmjet bankës nga Italia në Shqipëri, në favor të vjehrrit (huadhënësit). Më pas, një pjesë e kësaj shume

²⁰ Përllogaritur në mënyrë përpjesëtimore deri në momentin e blerjes së pasurisë.

është përdorur për blerjen (porositjen) e një apartamenti në *** (27.000 euro) për llogari të z. A. K. (i cili edhe sot banon në këtë apartament) dhe një pjesë e është dhënë subjektit si hua. Ky veprim është bazuar edhe te marrëdhënia shumë e mirë (vjuhërr/dhëndër) midis tyre. Arsyeja pse në fillim nuk është paguar e gjithë shuma për blerjen e apartamentit qëndron në faktin se apartamenti objekt shitblerje ka qenë ende në proces ndërtimi, pa leje ndërtimi dhe, për rrjedhojë, pa certifikatë pronësie. Nga përmbajtja e deklaratës noteriale nr. ***, datë 30.12.2010, rezulton se është paguar shuma 27.000 euro dhe se pjesa tjetër e çmimit të apartamentit do të paguhej në momentin e hartimit të kontratës përfundimtare të shitblerjes, pasi të kryhej procesi i legalizimit dhe i regjistrimit të pasurisë.

Vlerësimi i Komisionit

84. Trupi gjykues, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha përgjigjet, shpjegimet, argumentimet dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson se shuma 15.000 euro, e marrë hua nga shtetasi F. Gj., si dhe ato për të cilat subjekti ka deklaruar se i ka marrë nga shtetasi K. K. dhe B. B., duhet të merren në konsideratë në analizën financiare si të ardhura të ligjshme, pasi ato janë shpjeguar bindshëm nga subjekti dhe janë provuar edhe nëpërmjet dokumenteve mbështetëse.

85. Ndërkohë që, lidhur me shumën prej një milion lekësh që subjekti ka marrë hua në vitin 2010 nga znj. L. C., trupi gjykues çmon se ajo nuk mund të merret në konsideratë në analizën financiare të këtij viti, si një e ardhur e ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, pasi, ndonëse rezulton i provuar dhe i deklaruar nga subjekti fakti i marrjes së kësaj huaje, subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë burimin e ligjshëm financiar të huadhënësës për sa i përket shumës në fjalë.

86. Pretendimi i subjektit se znj. L. C. (huadhënësja) kishte marrë si paradhënie në gusht të vitit 2010, një pjesë të shumës që përbënte çmimin e shitjes së një pasurie prej saj, me të cilën kishte mundur të huazonte në favor të subjektit shumën prej një milion lekësh, nuk qëndron, për sa kohë bie ndesh me përmbajtjen e kontratës së kësaj shitjeje. Në fakt, kontrata e shitblerjes me nr. ***, datë 12.10.2010 – ndryshe nga sa ka deklaruar/mohuar subjekti i rivlerësimit – në pjesën ku përshkruan çmimin e shitjes, specifikon se: “[...] të hollat u likuiduan sot në dorë jashtë kësaj zyre noteriale [...]”. Për rrjedhojë, nga momenti që përmbajtja e kësaj kontrate nuk mund të kundërshtohet me deklarata të mëpashme të subjektit, apo edhe të vetë palëve, për sa kohë nënshkrimi i të cilës është kryer përpara një noteri publik, në garanci të shprehjes së vullnetit të lirë së palëve.

87. Trupi gjykues çmon se, në mungesë të provave ligjore të kundërta (të periudhës në fjalë dhe të prodhuara përgjatë procesit të rivlerësimit, me peshë së paku të barasvlershme – me kontratën *de qua* – apo me fuqi provuese më të lartë), vlera provuese e kësaj kontrate e përjashton mundësinë e konsiderimit si të mirëqenë versionin e paraqitur nga subjekti mbi burimin nga huadhënësja, sipas të cilit pagesa e një pjese të çmimit është kryer disa muaj më herët nga nënshkrimi i saj. Për rrjedhojë, në kushtet kur shuma prej një milion lekësh, që subjekti ka marrë hua nga znj. L. C. në vitin 2010, nuk mund të konsiderohet në analizën financiare si një e ardhur me burim financiar të ligjshëm – në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016 – rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë financiare prej 819.727 lekësh për blerjen e kësaj pasurie.

❖ Autoveturë tip “Daimler Chrysler”, prodhim i vitit 2005, blerë në vitin 2016 në vlerën 400.000 lekë

88. Kjo pasuri është deklaruar rregullisht në DPV dhe në deklaratën “Vetting”, 100 % në pronësi të subjektit, me vlerë 400.000 lekë dhe me burime krijimi të deklaruara nga të ardhurat familjare.

89. Blerja është kryer nëpërmjet kontratës me nr. ***, datë 20.5.2016, nga ku çmimi i blerjes rezulton të jetë 400.000 lekë.

90. Gjendja financiare e periudhës janar – maj 2016 ka konsistuar si në tabelën më poshtë:

Të ardhura	Janar – maj 2016
Të ardhura nga paga	798 092
Të ardhura nga qiraja	91 666
Shitur automjet i vjetër	250 000
Shpenzime	
Shpenzime udhëtimi	-54 108
Shpenzime jetese	-489 775
Blerje automjeti	-400 000
Rezultati	195 875

91. Për rrjedhojë, në vijim të analizës financiare për vitin 2016, deri në momentin e blerjes së kësaj pasurie – në maj të vitit 2016 – ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshëm burime financiare të ligjshme për blerjen e këtij automjeti dhe e ka deklaruar rregullisht atë – për rrjedhojë, nuk konstatohen problematika lidhur me këtë pasuri.

Analiza financiare

92. Në mënyrë të detajuar sipas viteve, Komisioni ka analizuar të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, detyrimet dhe mjaftueshmerinë e likuiditeteve për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet – me të ardhura të ligjshme, për periudhën 2003 – 2016, si në tabelën që vijon:

Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Sulejman Kurti

Analiza Financiare	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	0	0	5 756 727	224 981	228 767	192 496	750 437	4 403 339	-7 702	-5 305	262 786	3 602	1 966	582 980
Truall me Sip. 138 m2 nga e cila 92m2 banim, Librazhd														
Truall me Sip. 25m2, Librazhd														
Autoveture Benz me targë ***		200 000												
Shitesh kati + çati në ndërtimin ekzistues 143m2+90m2			6 551 621											
Rikonstruksion banesë				200 000	200 000	100 000	150 000							
Pajisje elektroshtepiake						150 000								
Mobilim shtëpie							500 000							
Apartament-Garsoniere me Sip. 33.8m2, Tirane								4 391 400						
Autoveture Benz me targë ***											250 000			0
Autoveture Benz me targë ***														400 000
Ndrysishim likuiditeti	0	-200 000	-794 894	24 981	28 767	-57 504	437	11 939	-7 702	-5 305	12 786	3 602	1 966	182 980
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	1 000 000	800 000	5 106	30 087	58 854	1 350	1 787	13 726	6 024	719	13 504	17 106	19 072	202 052
DETYRIME	0	0	1 848 672	-741 603	-665 067	366 000	-518 947	2 611 674	-897 166	-763 345	-777 107	-748 199	-688 250	341 460
Kredi RZB 400 000 leke, kredi nr. ***			348 672	-191 603	-165 067									
Hua 1 000 000 pa afat pa interes, L. & B. B.			1 000 000	-550 000		-450 000								
Hua 500 000 pa afat pa interes, M. & K. K.			500 000		-500 000									
Kredi RZB 816 000 leke, kredi nr. ***						816 000	-518 947	-297 053						
Kredi për blerje apartamenti RZB 1 020 000 leke, kredi nr. ***								826 577	-497 166	-329 411				
Hua për blerje apartamenti 1 000 000 leke L. C., me afat 3 v me interes								-400 000		-700 000				
Hua për blerje apartamenti 15 000 EUR, F. Gj. afat 3v me interes							2 082 150		-698 600	-280 420	-280 230	-688 250	-270 540	
Kredi RZB 1 040 000 leke, kredi nr. ***									964 667	-496 687	-467 979			
Kredi RZB 612 000 leke, kredi nr. ***														612 000
PASURI NETO	0	0	3 908 055	966 585	893 834	-173 504	1 269 384	1 791 665	889 464	758 040	1 039 893	751 801	690 216	241 520
TE ARDHURA deklaruar	796 863	1 061 913	1 173 344	1 656 000	1 590 000	1 564 000	1 843 000	1 805 000	2 200 000	1 945 000	2 261 311	2 348 770	2 181 676	2 385 423
TE ARDHURA dokumentuar	837 150	1 069 399	1 242 140	1 658 754	1 547 482	1 563 671	1 843 254	1 802 228	2 184 394	1 944 803	2 278 518	2 364 652	2 181 676	2 385 423
Paga SR	580 792	799 851	813 344	890 000	870 000	795 000	995 000	995 000	1 000 000	1 015 000	1 091 311	1 349 370	1 377 637	1 359 787
Paga BSH	216 071	262 062	260 000	256 000	360 000	409 000	448 000	460 000	500 000	500 000	529 400	554 039	555 636	
Te ardhura qiraje			100 000	510 000	360 000	360 000	400 000	350 000	400 000	350 000	350 000	250 000	220 000	220 000
Te ardhura qiraje Tirane									300 000	80 000	120 000	120 000		
Shitur Autoveture Benz me targë ***											200 000			
Shitur Autoveture Benz me targë ***														250 000
Qira			100 000	510 000	360 000	360 000	400 000	350 000	700 000	430 000	470 000,00	470 000	250 000	220 000
Paga SR vertetur	621 079	807 337	882 140	859 808	824 380	794 671	995 254	994 109	1 005 671	1 015 286	1 091 311	1 349 370	1 377 637	1 359 787
Paga BSH vertetur	216 071	262 062	260 000	288 946	363 102	409 000	448 000	458 119	478 723	499 517	517 207	545 282	554 039	555 636
SHPENZIME	469 320	549 320	781 593	591 205	626 641	748 373	1 413 929	809 892	1 087 783	1 209 864	1 192 246	1 470 005	1 140 621	1 758 562
Shpenzime udhëtimi			18 381			49 273	27 434	27 762	103 725	103 393	35 053	201 758	3 441	151 502
Shpenzime jetese	469 320	469 320	547 785	547 785	615 442	683 100	950 000	683 100	683 100	705 120	705 120	1 099 990	1 121 380	1 175 460
Interesa + shpenzime per kredine			15 427	43 420	11 199	16 000	107 287	79 030	110 104	43 229	96 048	28 147		
Studime master							329 208							
Shpenzime mjekesore														400 000
Shpenzime shkollimi I, S. K. pranë ***									190 854	338 122	350 525	140 110		
Sigurime								20 000	20 000	20 000	5 500		15 800	31 600
Arredim mobilim		80 000	200 000											
Analiza dokumentuar	367 830	520 079	-3 447 508	100 965	27 007	988 802	-840 059	-799 329	207 148	-23 101	46 379	142 846	350 839	385 341
CASH në leke	1 000 000	800 000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	200 000
Diferenca e pa mbuluar për ndërtimin 1998	-1 119 350													
Diferenca e pa mbuluar	-5 109 997													
TOTAL E PA MBULUAR	-6 229 347													

93. Në konkluzion të analizës financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme, për të kryer të gjitha investimet dhe njëkohësisht për të përballuar shpenzimet, apo për të realizuar kursimet e deklaruara.

94. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ mbi kriterin e pasurisë, në lidhje me problematikat e konstatuara më sipër, ka paraqitur në Komision shpjegimet e tij – si në paragrafët e sipërcituar – si dhe dokumentacion mbështetës, të cilat janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues në mënyrën e shprehur më sipër, përgjatë arsyetimeve të kryera për secilin pretendim të subjektit që lidhej me burimet financiare dhe me pasuritë e analizuara.

95. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se për sa i takon kriterit të pasurisë, bazuar në analizën financiare të kryer nga njësia ligjore, subjekti i rivlerësimit, z. Sulejman Kurti, nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme, sipas përcaktimeve të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, për të kryer të gjitha investimet e konstatuara dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet, apo për të realizuar kursimet e deklaruara. Nisur nga ky rezultat financiar, si dhe referuar problematikave që kanë rezultuar lidhur me deklaratimet e pasurive, të sipërtrajtuara, trupi gjykues çmon se duhet të aplikohet pika 3, e nenit 61, e ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

96. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Sulejman Kurti. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. ***, për subjektin e rivlerësimit është përcjellë në Komision një raport me nr. *** prot., datë 31.10.2017, ku ishte konstatuar “Përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës të subjektit të

rivlerësimit, z. Sulejman Kurti". Në vijim, nga DSIK-ja është përcjellë një tjetër raport me nr. *** prot., datë 2.8.2019, i cili është deklasifikuar²¹ pjesërisht në datën 11.9.2019.

97. Sipas këtij raporti rezulton se në bazë të informacioneve të përcjella nga organet ligjzbatuese, ka dyshime se subjekti i rivlerësimit, z. Sulejman Kurti, është përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, të shfaqura në formën e korrupsionit, dhe për rrjedhojë ky institucion ka ndryshuar vlerësimin fillestar, nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri për vijimin e ushtrimit të detyrës së tij.

98. Përgjatë hetimit administrativ dhe rivlerësimit të kryer nga Komisioni – sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës – janë studiuar/lexuar edhe materiale të klasifikuara. Për të verifikuar mbështetjen dhe besueshmërinë e informacioneve të klasifikuara, Komisioni ka kërkuar dhe ka administruar dokumente nga institucione publike, si dhe disa dosje hetimore dhe gjyqësore, që mund të kishin lidhje me veprimtaritë e lartpërmendura.

99. Nga shqyrtimi dhe analizimi i këtij materiali, përtej dyshimeve që mund të lindnin mbi rrethana të caktuara, nuk rezultuan prova apo *indicie* të bazuara në fakte apo në shkelje profesionale të atij lloji që do të mund të gjeneronte dyshime të arsyeshme se këto të fundit (veprimet apo shkeljet profesionale), kishin pasur si qëllim të vetëdijshëm nga ana e subjektit favorizimin apo ndikimin e paligjshëm në favor të personave të tretë, kundrejt një përfitimi të paligjshëm prej tij.

100. Komisioni, me anë të rezultateve të hetimit kryesisht, i njoftoi subjektit të rivlerësimit konstatimet dhe konkluzionet e arritura nga Grupi i Punës së DSIK-së, në lidhje me papërshtatshmërinë e tij për vazhdimin e detyrës. Subjekti, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, shpjegoi se konkluzionet e DSIK-së nuk qëndronin, pasi ai nuk ishte përfshirë ndonjëherë në veprimtari korruptive apo të kundërligjshme dhe as nuk kishte pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm, por kishte vepruar gjithmonë me ndershmëri.

101. Nga hetimi administrativ dhe rivlerësimi i kryer nga Komisioni, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, bazuar në provat dhe dokumentet e administruara, si dhe mbi dokumentet dhe informacionet e klasifikuara, të verifikuara nga trupi gjykues pranë organeve ligjzbatuese, në vlerësimin e çështjes në tërësi në lidhje me kriterin e figurës, arrin në përfundimin se në raportin e dërguar nga DSIK-ja vlerësimi i kryer nuk përmban rrethana bindëse, të tilla që të merren parasysh dhe të mjaftojnë për papërshtatshmëri apo për konstatimin e ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar. Informacionet dhe dyshimet e ngritura mbi rrethana të tjera dhe mbi veprime korruptive të përsëritura, nuk rezultojnë të provuara/bazuara mjaftueshëm, për të konkluduar bindshëm mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në to.

102. Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk i konsideron të mjaftueshme informacionet, *indiciet* dhe dyshimet e ngritura për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij. Për rrjedhojë, konstatimet e mësipërme nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit – sipas pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

²¹ Vendim deklasifikimi nr. ***, datë 20.7.2018.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Vlerësimi i aftësive profesionale nga KLD

103. Sipas raportit për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Sulejman Kurti, të kryer nga Grupi i Punës, i ngritur pranë Inspektoratit të KLD-së, datë 25.6.2018, nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore, nuk janë konstatuar shkelje profesionale lidhur me gjykimet e kryera apo me aktet e përpiluara nga ky subjekt.

104. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Sulejman Kurti, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni

Lidhur me denoncimet nga publiku

105. Komisioni pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, si dhe në bazë të informacioneve të tjera të marra nga organet ligjzbatuese, bazuar në nenin 53, të ligjit nr. 84/2016, ka administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore për të rivlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, z. Sulejman Kurti. Nga shqyrtimi i këtyre dosjeve ka rezultuar si më poshtë vijon:

- **Lidhur me procedimin penal të shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe të konkluduar me vendimin nr. ***, datë 18.11.2017**

106. Nga analizimi i kësaj dosjeje është konstatuar se kjo çështje është shqyrtuar dhe vendosur nga subjekti i rivlerësimit, i cili me vendimin e sipërcituar ka vlerësuar si të ligjshëm arrestimin e shtetas K. T., si dhe ka caktuar ndaj saj masën e sigurimit personal “detyrim paraqitjeje pranë Policisë Gjyqësore”.

107. Në vendimin objekt analize nuk rezulton e mirëmotivuar dhe e argumentuar nga subjekti ekzistenca e rrezikshmërisë shoqërore të të dyshuarës, në një shkallë të tillë që të justifikonte nevojën për caktimin e një mase sigurimi personal, apo lidhur me ekzistencën e ndonjë tjetër rrethane sipas rasteve të parashikuara nga neni 228, pika nr. 3, i Kodit të Procedurës Penale.

108. Gjithashtu, vendimi në fjalë nuk rezulton i motivuar/argumentuar lidhur me parashikimet e nenit 229 dhe 230, pika 1, e Kodit të Procedurës Penale. Mbi mospërputhjet e fakteve dhe rrethanave me bazën ligjore të cituar nga subjekti i rivlerësimit, në vendimin nr. ***, si dhe mbi mungesën e arsytimit apo mbi arsytimin e gabuar në të, është shprehur edhe Gjykata e Apelit Durrës. Kjo e fundit, me vendimin nr. ***, datë 11.12.2017, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të subjektit të rivlerësimit, të cilin e ka çmuar të pabazuar. Kjo gjykatë ka evidentuar mungesën e motivimit të vendimit të subjektit, lidhur me vlerësimin e gabuar të kushteve dhe të kriterëve ligjore për vlerësimin e ligjshëm të arrestit të zonjës K.T., dhe mbi caktimin e masave të sigurimit personal, nisur nga fakti se dyshimet e ngritura lidheshin një kundërvajtje penale dhe jo me një krim.

109. Subjekti ka dhënë shpjegimet e tij lidhur me këtë vendimmarrje, por ato janë çmuar nga trupi gjyqësor jo bindëse dhe kontradiktore me argumentimet e kryera nga vetë subjekti i rivlerësimit në arsytimin e vendimit në fjalë (kryesisht për sa i përket aplikimit të masës së sigurisë personale në ato rrethana dhe mbi panevojshmërinë e përdorimit të relacionit specifik mbi rrethanat të përgatitur nga OPGJ-ja).

➤ **Lidhur me procedimin penal nr. ***, të regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në datën 12.11.2018**

110. Komisioni, pasi ka analizuar dokumentacionin e administruar mbi këtë çështje penale – të shqyrtuar dhe vendosur nga subjekti i rivlerësimit me gjykim të shkurtuar, me vendimin nr. ***, datë 15.1.2019 – nuk ka konstatuar shkelje procedurale, cilësime të gabuara të veprave penale, apo përdorim i gabuar i bazës ligjore, por ka rezultuar se dënimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit ndaj të pandehurit A. S., janë pothuajse në nivelin e dënimeve minimale të parashikuara nga dispozitat ligjore përkatëse.

111. Gjithashtu, theksohet se vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është konfirmuar nga Gjykata e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. ***, ka ulur dënimin përfundimtar, në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal dhe të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale.

➤ **Lidhur me procedimin penal nr. ***, të regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në datën 26.4.2010**

112. Pasi është analizuar një dosje voluminoze lidhur me këtë procedim, Komisioni u përqendrua në studimin e atyre akteve/veprimeve dhe dokumenteve që lidheshin me aktivitetin profesional të kryer nga subjekti i rivlerësimit, i cili rezultoi se ka shqyrtuar vetëm një kërkesë të paraqitur nga njëri prej të pandehurve, për pavlefshmëri të akteve të marra nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Nga kjo analizë ka rezultuar se:

- i. Subjekti i rivlerësimit, z. Sulejman Kurti, në datën 28.12.2009, nëpërmjet vendimit nr. 445, ka vendosur të pranojë kërkesën e të pandehurit dhe për pasojë ka urdhëruar heqjen nga procedimi penal të një sërë regjistrimesh (CD dhe DVD), si dhe asgjësimin e tyre, pasi ka vlerësuar se ato janë marrë në shkelje të parashikimeve ligjore, për sa i përket procedurave të marrjes së provave.
- ii. Ky vendim – i dhënë nga subjekti i rivlerësimit – është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, si dhe nga Gjykata e Lartë, e cila, me vendimin nr. ***, ka konfirmuar paligjshmërinë e materialit të hequr nga dosja në fjalë, pasi autorizimi i prokurorit për përgjimet e kryera nuk ishte kaluar për vlerësim në gjykatën kompetente, sipas parashikimeve të nenit 222 të Kodit të Procedurës Penale.

113. Për sa më lart, nuk ka rezultuar të ketë pasur shkelje apo mangësi profesionale nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë çështje.

➤ **Lidhur me procedimin penal nr. ***, të konkluduar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në datën 10.3.2017, me vendimin nr. *****

114. Pas shqyrtimit të akteve të këtij procedimi penal ka rezultuar se çështja në fjalë kishte si objekt gjykimi akuzat e ngritura nga prokuroria kundër shtetasit A. C., e të tjerë, të akuzuar për kryerjen e veprave penale “shpërdorim të detyrës” dhe “korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”.

115. Në dosjen gjyqësore të kësaj çështjeje janë bërë pjesë, përveç të tjerash, edhe 40 CD me përgjime telefonike, 3 CD me përgjime dhe vëzhgime ambientale dhe 1 CD e kompanisë telefonike Vodafon.

116. Në vijim të analizës së dokumenteve të kësaj çështjeje, duket se subjekti i rivlerësimit, në shqyrtimin e akteve dhe në vendimmarrjen e kryer, ka aplikuar një bazë ligjore në rrethana dhe mbi fakte të ndryshme nga ato për të cilat baza ligjore është konceptuar e parashikuar nga ligjvënësi dhe duke cilësuar ndryshe veprën penale, faktet dhe rrethanat, me pasojën e deklaramit të pafajshëm të së paku dy shtetasve (A. C. dhe A. Gj.), të përfshirë në veprime të kundërligjshme dhe dënimin e dy të tjerëve për një vepër penale të cilësuar ndryshe, në raport me faktet e provuara.

117. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, në lidhje me problematikat e konstatuara më sipër, ka paraqitur në Komision shpjegimet e tij, si dhe dokumentacion mbështetës edhe për kriterin e aftësive profesionale, nëpërmjet të cilave mbron qëndrimet e tij si të drejta dhe të marra bazuar në bindjen e brendshme. Duke specifikuar, përveç të tjerash, se subjekti edhe pse i respekton vendimet e gjykatave më të larta, nuk do të thotë se bie gjithmonë dakord me ato, pasi ai ka mënyrën e tij të vlerësuarit dhe të interpretuarit të ligjit dhe vendos në bazë të bindjes së tij të brendshme, dhe për rrjedhojë, në ato raste dhe rrethana do të merrte sërish të njëjtat vendime edhe sot, pasi është i bindur që ka bërë zgjidhjen e duhur të çështjeve në fjalë.

Vlerësimi i Komisionit

118. Nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se të dhënat e nxjerra nga disa prej dosjeve të administruara nga Komisioni, si dhe konstatimet lidhur me mënyrën e të punuarit (*modus operandi*) të subjektit, evidentojnë disa qëndrime të tij jo koherente dhe jo në përputhje të plotë me rrethanat dhe faktet konkrete që kanë rezultuar nga hetimet e kryera. Gjithsesi, Komisioni vlerësoi se ato nuk përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për të konkluduar për papërshtatshmërinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Sulejman Kurti, dhe si rrjedhim mbërrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit ligjor.

Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin:

- i. Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme – sipas parashikimeve të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës – për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet, apo për të realizuar kursimet e deklaruara. Për rrjedhojë, subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e deklaramit të pasurisë dhe duhet aplikuar pika 5, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 3, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.**
- ii. Në lidhje me kontrollin e figurës, në mungesë të provueshmërisë së plotë të dyshimeve të ngritura, subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm, sipas germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi, për sa i përket rivlerësimit të figurës, trupi gjykues nuk i konsideron të mjaftueshme informacionet dhe elementet – e administruara në nivel të dhënash dhe/ose dyshimesh – që ka pasur në dispozicion, për të konkluduar ndryshe dhe, për rrjedhojë, e konsideron subjektin e rivlerësimit të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**
- iii. Në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit janë konstatuar problematika të pamjaftueshme për të konsideruar subjektin nën nivelin minimal të përcaktuar nga dispozitat ligjore, dhe për rrjedhojë konsiderohet se subjekti ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.**

119. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjektit të rivlerësimit, z. Sulejman Kurti, me funksion gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, duhet t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës, në nenin D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e

Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikës 3 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Sulejman Kurti, me funksion gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.
 2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
 3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 6.11.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Firdes Shuli
Kryesuese

Lulzim Hamitaj
Relator

Valbona Sanxhaktari
Anëtare

Anisa Duka
Sekretare gjyqësore